

FJALA E DEPUTETES LINDITA METALIAJ

E ENJTE 15 SHTATOR 2022

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë shqiptarë,

Parlamentit tonë i është paraqitur për ratifikim memorandum i mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për shkëmbimin e informacionit në lidhje me emigracionin. Pra, ky memorandum ka në fokus emigracionin e paligjshëm të qytetarëve shqiptarë drejt Britanisë. Nënshkrimi dhe ratifikimi i kësaj marrëveshjeje nuk është kërkuar nga Shqipëria, por është kërkuar me urgjencë nga Britania e Madhe. Fakti që e ka kërkuar Britania e Madhe, do të thotë që e ka identifikuar emigracionin e paligjshëm si një problem të madh për Britaninë, për stabilitetin e saj social ekonomik, për sovranitetin e ligjit dhe qëndrueshmërinë e institucioneve të saj.

Fakti që i ka kërkuar Shqipërisë firmosjen e një memorandum i tillë për emigracionin, tregon se Shqipëria është identifikuar si vatër nga buron emigracioni masiv, ku vetëm në 6 muajt e parë të vitit janë larguar mbi 12000 qytetarë shqiptarë drejt Britanisë së Madhe. E pra, shteti shqiptar, qeveria, Kryeministri, parlamenti, deputetët sot duhet të ndihen të turpëruar dhe kokulur që Shqipëria, vendi ynë, është kthyer në problem për vendet e tjera. Kemi qenë problem në vitin 1991, por ia kemi faturuar rrëzimit të komunizmit dhe deri diku edhe na kanë mirëkuptuar. Kemi qenë problem pas vitit 1997 e përsëri na mirëkuptuan. Po sot pse ndodh ky eksod? Pse ndodh kjo ikje masive, aq sa për t'u bërë problem për vendet e tjera si Britania?

Në një kohë kur s'ka as përmbysje sistemi, s'ka as luftë civile? Por sot ka diçka tjetër, sot ka një luftë të Edi Ramës, të sistemit të tij oligarkik, të qeverisë, e cila qeveris me krimin e organizuar të integruar në shtet kundër qytetarëve shqiptarë. Sot ka një luftë kundër ekonomisë shqiptare për ta përvetësuar atë, luftë kundër institucioneve shqiptare për t'i rrënuar, pasi, nëse do të funksiononin institucionet, këta s'do mundeshin të sundonin. Pra, ka luftë kundër shqiptarëve,

luftë kundër Shqipërisë jo nga ndonjë pushtues i huaj, por nga vetë shteti i tyre, të cilin ata e paguajnë për t'i mbrojtur. Kjo është lufta me e tmerrshme që mund të ekzistojë. Kjo është një luftë pa barot e pa plumba, por është luftë për varfërimin e familjeve shqiptare.

Varfërimi është me djegës se baroti e se plumbi. Është luftë pa krisma, por është luftë me kërcitjen e vulave mbi kontratat e tenderëve e të koncesioneve korruptive, me të cilat paratë e shqiptareve merren dhe u falen oligarkëve pranë Edi Ramës. Paratë që duhej të shkonin për shkolla për fëmijët shqiptarë, shkojnë për udhëtime dhe pushime të fëmijëve të oligarkëve. Paratë që duhej të shkonin për qendra shëndetësore, shkojnë për rroba e çanta luksi. Paratë që duhej të shkonin për forcimin e rendit dhe të sigurisë, shkojnë për t'i fuqizuar ekonomikisht grupet kriminale të partisë, që nesër, kur të këtë zgjedhje, ata të jenë mjaftueshëm të fortë për të blerë vota, për të blerë komisionerë, për të blerë eksponentë të partisë kundërshtarë.

Kjo është lufta e Edi Ramës dhe e juntës së tij kriminale kundër shqiptarëve. Kjo luftë ka shkaktuar varfërim, pasiguri për jetën, pasiguri për pronën, pasiguri për shëndetin, për perspektivën, për të ardhmen. Shumë njerëz po rivlerësojnë nëse duhet të vazhdojnë të jetojnë në Shqipëri apo duhet të emigrojnë. Kur s'ke ekonomi, kur s'ke punë të qëndrueshme e të ardhura të mjaftueshme, kur s'ke shkolla cilësore për të arsimuar fëmijët, kur nuk ke sistem shëndetësor cilësor për t'u mjekuar dhe kur ke pasiguri totale mbi çfarë do të ndodhe nesër me punën, me tregun, me qetësinë dhe në horizont sheh vetëm trazira, pa dyshim që do të rivlerësosh nëse duhet të qëndrosh në këtë vend apo duhet të largohesh. Prandaj vijmë në pikën kritike, ku Britania e Madhe vjen i kërkon Shqipërisë këtë memorandum, sepse shqiptarët bëhen problem.

Arrijmë në pikën ku gazeta britanike "Telegraf" njofton se oficerët e policisë shqiptare do të vendosen në Dover të Anglisë dhe do të ndihmojnë në identifikimin dhe dëbimin e emigrantëve shqiptarë të paligjshëm. Njofton, gjithashtu, se ministri Çuçi do t'i paralajmërojë shqiptarët me dënim deri në 4 vjet burg dhe deportim nëse hyjnë ilegalisht në Mbretërinë e Bashkuar. Madje, gazeta në fjalë na përmend se jemi vend anëtar i NATO-s dhe aspirojmë anëtarësim në BE dhe nuk kemi parë asnjë konflikt prej 25 vjetësh. A ka diçka më poshtëruese për një vend se sa të

dërgojë policinë e saj në një vend tjetër për të dëbuar emigrantët? A ka dështim më të madh të shtetit, të ekonomisë, të institucioneve, të politikës?

Nuk është faji i shqiptareve që emigrojnë. Ata emigrojnë për një jetë më të mirë, mbi të gjitha, për t'u trajtuar si njerëz. Pyetja që shtrohet është: pse emigrojnë shqiptarët në këtë mënyrë e me këtë intensitet? Arsytet e shkaqet ne i dimë, pavarësisht se këta që janë në qeveri, nuk i pranojnë dhe, në vend që të japin ndonjë argument, gjëja e parë që u shkon në mendje është si të justifikohen e si të mashtrojnë. Nëse duam ta zgjidhim këtë problem, nuk ka nevojë as që policët shqiptarë të shkojnë në Dover, nuk ka nevojë që Edi Rama t'i kërcënojë e t'i paralajmërojë se kush kalon kufirin me Britaninë, do të dënohet deri 4 vjet burg.

Ky problem zgjidhet duke riformtuar ekonominë dhe modelin e ekonomisë, që në ekonominë shqiptare të jenë pjesëmarrëse shumica e shqiptarëve, jo 5% e lidhur me pushtetin të pasurohen dhe 95% vetëm të mbijetojnë, të hanë një copë bukë me vështirësi dhe të zhyten në borxhe gjithë jetën; zgjidhet duke ua hequr paratë grupeve kriminale të partisë, duke mos u dhënë më tenderë me fitime të fryra, por ato para të shkojnë për forcimin e policisë, për forcimin e rendit, për garantimin e sigurisë dhe të qetësisë mendore për shqiptarët; zgjidhet duke ndërtuar një administratë profesionale. Në administratën e sotme shtetërore punësohet militanti, punësohen servili dhe keqberësi, ndërsa nxënësit e shkëlqyer mbetën pa punë, konkurrojnë dhe nuk pranohen, përpiqen, por dekurajohen nga sistemi, ku mund të punësohesh vetëm me parti ose me mik.

Ky problem zgjidhet duke ndërtuar shkolla cilësore, me mësues cilësorë dhe me administrim cilësor. Në sistemin e sotëm arsimor punësohen dhe promovohen mësues e drejtues, të cilët kanë lidhje me partinë qeverisëse, por çfarë lidhjeje ka arsimi me qeverinë? Arsimi duhet të jetë i pavarur dhe profesional. Askund në vendet europiane nuk promovohet apo izolohet mësuesi vetëm pse ka lidhje me partinë-shtet. Mësuesi është mësues. Shkolla është shkollë dhe partia është parti; secili në vendin që i takon. Por këtu ndodh krejt e kundërta. Këto janë arsyet pse në qarkun e Lezhës numri i nxënësve ka rënë ndjeshëm. Nga 18800 nxënës, që u regjistruan në vitin 2021, këtë vit janë ulur në bankat e shkollës 15111 nxënës, pra 3000 nxënës më pak se një vit më parë, ndërkohë që Rama dhe oborrtarët e tij propagandojnë çdo ditë ndërtimin e

shkollave të reja, rritjen e cilësisë, përmirësimin e kurrikulave, duke e anashkaluar qëllimisht realitetin që po mbyllet arsimin.

Flasim për mure shkollash që po ndërtohen, ngjyra klasash apo banka të reja, por përpara na shfaqen klasa boshe, me më pak nxënës, shkolla që mbyllen, bashkim klasash dhe mësues që dalin pa punë. Ka më pak nxënës këtë vit në Torovicë, më pak nxënës në Balldre, në Kallmet, në Shënkoll, në Zadrimë, në Zejmen dhe në Ungrej. Pra, e gjithë kjo situatë e zyrtë në arsim ka disa faktorë që e kanë shkaktuar, ku më kryesori është keqqeverisja nga socialistët. Edi Rama e ka bërë Lezhën dhe Shqipërinë të pajetueshme dhe të pashpresë me politikën e tij. Shumë familje lezhjane dhe sidomos nga fshati kanë emigruar, nuk po ikin vetëm të rinjtë dhe familjet në pamundësi ekonomike, por Shqipërinë po e braktisin intelektualët dhe familjet me ekonomi, pasi Rilindja ka vrarë shpresën për një Lezhë dhe një Shqipëri më të mirë.

Mjafton të bësh një kalim në rrugët e qytetit dhe thuajse në çdo vend publik ke njoftime: “kërkojmë kamarierë, kërkojmë banakier, kërkojmë shitës buke” e shumë njoftime të tilla. E gjitha kjo shpjegohet me largimin masiv jashtë vendit. Keqqeverisja dhe korrupsioni godasin njëllonj botuesin, sovranin, si të majtë apo të djathtë. Kjo është e vërteta që hedh poshtë atë që qeveria bërtet me të madhe se “Jemi mirë, po bëjmë hapa përpara, se ekonomia po rritet, se arsimi po zhvillohet dhe se turizmi po shkëlqen”. Për këtë të fundit, qeveria jep statistika sikur Shqipëria kishte shumë vështirësi të përballonte kaq shumë turistë, se ua kaluam me numër vizitorësh edhe vendeve shumë të zhvilluara në këtë drejtim.

Madje ironia shkon deri aty sa që grekët boshatisën ishujt e tyre për të ardhur në Shqipëri, se londinezët zgjedhën Shqipërinë përpara çdo vendi tjetër, dhe kjo falë punës së qeverisë! Padyshim, të gjithë do të donim që Shqipëria të ishte e para jo vetëm në fushën e turizmit, por në të gjitha fushat, por nuk mund të bëhet turizëm duke abuzuar me shifrat. Emigrantët që kthehen pranë familjeve të tyre për pushime janë atdhetarët tanë, janë vëllezërit dhe motrat tona, nuk janë turistë, por janë kontributorë në zhvillimin e ekonomisë familjare.

E, në fakt, sivjet turizmi u përball me pasiguri në plazhe, me trafik të rënduar dhe me tolerim të abuzimeve të çmimeve. U përball me mungesë personeli, pasi kanë emigruar, madje shumë biznese të zonave bregdetare iu drejtuan vëllezërve nga Kosova për t'i punësuar, duke rritur

kostot e shpenzimeve. E, fatkeqësisht, ky është realiteti shqiptar: shpopullim, eksod masiv, varfëri, papunësi, mbijetesë! Faleminderit!